



Datë: 30.05.2025
Numër Protokoll: 4022/2025

A.nr.602/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës– Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Avdyll Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.602/2025, të datës 04.04.2025, të parashtruar nga ankuesi F.K, të cilin me autorizim e përfaqëson Avokat Labinot Murati nga Prishtina, kundër organit të punësimit/ Agjencia Kadastrale e Kosovës, në çështjen juridike “*transferim për shkak të ristrukturimit*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafin 3 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të datës 30.05.2025, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet si e bazuar** ankesa me numër A.nr.602/2025, e datës 04.04.2025, e parashtruar nga ankuesi F.K.
- II. Anullohet** Vendimi Nr.R.AKK 665/2025, i datës 25.03.2025, i Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik/Ministria e Punëve të Brendshme dhe pika II me numër rendor 3 e Raportit Përfundimtar të datës 21.03.2025, të Komisionit të Instrukimit të Agjencisë Kadastrale të Kosovës, lidhur me propozimin për transferimin e ankuesit, dhe çështja kthehet në *rishqyrtim dhe rivendosje* tek organi i njëjtë.
- III. Obligohet** Komisioni i Ristrukturimit i Agjencisë Kadastrale të Kosovës, që në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, bërë bëmë rishqyrtimin e çështjes së transferimit të ankuesit si pasojë e riorganizimit të institucionit, duke marrë parasysh gjetjet dhe pikëpamjet juridike si në arsyetimin e këtij vendimi.
- IV.** Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim për veprimet e ndërmarra.

A r s y e t i m

Nëpunësi civil F.K (në tekstin e mëtejshëm referuar: ankuesi), më datë 04.04.2025, përmes përfaqësuesit të tij me autorizim, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit Nr.R.AKK 665/2025, të datës 25.03.2025 të Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik/MPB, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurale, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të ligjit material.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 10.04.2025 dhe 12.05.2025, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Agjencia Kadastrale, ndërsa, Këshilli më datë 17.04.2025 dhe 16.05.2025, ka pranuar përgjigjen në ankesë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me nr. protokolli 2248/2025 të datës 04.04.2025 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Autorizimin e datës 03.04.2025; Vendimin me Nr.R.AKK 665/2025, të datës 25.03.2025 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrarëve Publik/MPB; Akt Emërimit e datës 11.01.2012; Vendimin e datës 27.02.2015 të Kryeshefit Ekzekutiv të AKK-së; Formularët e vlerësimit të rezultateve enë punës datës 31.12.2016, 29.12.2017, 31.12.2020, 28.02.2024, 28.01.2022, 28.02.2023, 28.02.2025; Certifikatën e datës 10.05.2016, 31.10.2003, 07.06.2007, 03.10.2007; Mirënjohje e datës 20.12.2024; Emailin e datës 26.09.2023, 11.04.2024 nga A.G; Emailin e datës 27.01.2024 nga H.P; Emailin e datës 24.01.2024 nga N.Sh; Diplomën me Nr. 351 të ankuesit; Diplomë master e datës 12.10.2015 dhe 07.05.2019; Vendimin Ref.Nr.6-2595 të datës 14.10.2019 të MASHT; Vendimin Ref.Nr.6-2424 të datës 16.05.2016 të MASHT; Vendimin me Nr. 60/2017 të datës 23.10.2017 të Ministres së MMPH; Ankesë, kërkesë për sqarim e datës 02.02.2023 nga ankuesi për Menaxheren e Personelit të AKK; Përgjigjen e datës 02.03.2023 nga Menaxherja e Personelit e AKK për ankuesin; Vendimin me Nr. 14/15 të datës 21.12.2015; Kopjen e ID-së së ankuesit; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 10.04.2025; Përgjigjen në ankesë e datës 17.04.2025; Raportin përfundimtar i Komisionit të Ristrukturimit i datës 21.03.2025; Vendimin V.nr.2551/2024 të datës 23.12.2024 për themelimin e Komisionit të Ristrukturimit; Përshkrimin e punës për pozitën Udhëheqës i Divizionit për Infrastrukturës Kombëtare të Informacioneve Hapësinore, Udhëheqës i Divizionit për Hartën Kadastrale; Rregulloren (ZKM) Nr.13/2024 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Agjencinë Kadastrale të Kosovës; Kërkesë shtesë për përgjigje në ankesë e datës 12.05.21026; Përgjigjen në kërkesën e datës 16.05.23025; Përgjigje në ankesë e datës 20.11.2018 nga ankuesi për E.M; Raportin e datës 02.12.2019 nga ankuesi, D.H dhe Q.S; Përgjigje në kërkesë e datës 19.09.2019 nga ankuesi për Sh.K; Elaborati i shpronësimit datës 04.12.2024 nga H.P dhe ankuesi për A.J; Aktvendimin e datës 07.08.2024 nga ankuesi; Njoftimin e datës 08.08.2024 nga M.K për A.Sh; Aktvendimin e datës 09.08.2024 të ankuesit; Aktvendimin e datës 22.08.2024 të ankuesit; Aktvendimin e datës 09.08.2024 të ankuesit; Përgjigje në ankesë e datës 23.01.2024 nga D.H; Njoftim sipas kërkesës datës 15.01.2023 nga M.K; Përgjigje e datës 10.01.2024 nga E.X; Elaborati i shpronësimit datës 24.01.2024, 16.01.2024 nga H.P dhe ankuesi; Aktvendimi i datës 09.07.2024 nga ankuesi; Njoftimi i datës 09.07.2024 nga M;K; Aktvendimi i datës 12.07.2024 nga ankuesi; Elaborati i shpronësimit i datës 05.06.2024 nga D.H; Vendimin me numër protokolli 3254/2025 i datës 19.05.2025 për shtyrjen e afatit për vendosje të ankesës së ankuesit.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të dërguara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankuesit është e bazuar, ndërsa lënda duhet të kthehet në ri-shqyrtim dhe rivendosje tek organi i njëjtë, sepse:

Nga administrimi i shkresave të lëndës, Kolegji i Këshillit ka gjetur se ankuesit fillimisht sipas Akt Emërimit të datës 11.01.2012, ka mbajtur pozitën *Shef i Sektorit për Matje* në kuadër të Agjencisë Kadastrale të Kosovës, ndërsa, pas miratimit të Rregullores Nr. 20/2014 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Agjencinë Kadastrale të Kosovës, me Vendimin e datës 27.02.2015 të Kryeshefit Ekzekutiv të Agjencisë Kadastrale të Kosovës është emëruar në pozitën *Udhëheqës i Sektorit për Infrastrukturë Kombëtare të Informacioneve Hapësinore*, e të cilën pozitë ankuesi pretendon së nuk e ka ushtruar asnjëherë.

Tutje sipas Vendimit me Nr.140/2024, të datës 05.08.2024, të Kryeministrit të Republikës së Kosovës, është miratuar Rregullorja (ZKM) Nr.13/2024 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Agjencinë Kadastrale të Kosovës, me ç'rast edhe institucion i është nënshtruar procesit të riorganizimit, gjegjësisht, Drejtori i Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik në Ministrinë e Punëve të Brendshme me Vendimin me V.nr.2551/2024, të datës 23.12.2024, ka themeluar Komisionin e Ristrukturimit për Agjencinë Kadastrale të Kosovës, ndërsa, ky i fundit më datë 21.03.2025, ka miratuar Raportin përfundimtar lidhur me procesin e ristrukturimit në Agjencinë Kadastrale të Kosovës, duke propozuar që ankuesi të sistemohet nga pozita Udhëheqës i Sektorit për Infrastrukturë Kombëtare të Informacioneve Hapësinore në pozitën Udhëheqës i Divizionit për Infrastrukturë Kombëtare të Informacioneve Hapësinore.

Drejtori i Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, në zbatim të rekomandimit të Komisionit të Ristrukturimit, më Vendimin me Nr.R.AKK 665/2025, të datës 25.03.2025, ka bërë sistemimin e ankuesit, ashtu që nga Udhëheqës i Sektorit për Infrastrukturë Kombëtare të Informacioneve Hapësinore e ka transferuar në pozitën Udhëheqës i Divizionit për Infrastrukturë Kombëtare të Informacioneve Hapësinore.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundërshton ligjshmërinë e Vendimit Nr.R.AKK 665/2025, të datës 25.03.2025, të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik/MPB, duke pretenduar së akti i kontestuar është nxjerrë në kundërshtim me dispozitat ligjore dhe me vetë gjendjen faktike ngase nuk është mbështetur në përvojën e tij shumë vjeçare nga vitit 2001 si ekspert i matjeve, ngase në pozitën ku është caktuar Udhëheqës i Sektorit për Infrastrukturë Kombëtare të Informacioneve Hapësinore, asnjëherë nuk e ka ushtruar ngase situata juridike me atë faktike ndryshojnë sepse ky sektor nuk është funksionalizuar asnjëherë dhe këtë fakt nuk e ka pasur parasysh as komisioni i ristrukturimit as organi që e ka nxjerr vendimin e kontestuar. Duke marr parasysh që pozita Udhëheqës i Divizionit për hartën Kadastrale është e lirë, pretendon se duhet të transferohet në këtë pozitë sepse përvoja e ushtruar në institucion përputhet plotësisht me pozitën e tillë. Komisioni i ristrukturimit nuk ka marr për bazë nenin 13 paragrafi 7 të Rregullores Nr. 02/2024 për Transferimin e Nëpunësve Civilë. Kërkon, që të aprovohet ankesa, të anulohet akti i kundërshtuar me ankese dhe të detyrohet institucioni të transferoj në pozitën Udhëheqës i Divizionit për Hartën Kadastrale.

Në kuptim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankuesit lidhur me të drejtën e tij të sistemimit për shkak të riorganizimit, Kolegji i Këshillit, iu referua dispozitave të nenit 66 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se: *1. Nëse për shkak të shuarjes apo ristrukturimit të institucionit, pozita e mëparshme e një nëpunëse/i civil shuhet, ajo/ai mund të transferohet në një pozitë tjetër të shërbimit civil të së njëjtës kategori. 2. Transferimi, sipas paragrafit 1. të këtij neni, mund të bëhet: 2.1. në të njëjtin institucion; 2.2. në institucionin që është bashkuar institucioni i shuar, në institucionin që është ndarë apo në institucionin që ka marrë funksionet që kryente më parë nëpunësja/i; 2.3. në agjencinë ekzekutive të institucionit të ristrukturuar; 2.4. në një institucion tjetër të shërbimit civil. 3. Në çdo rast shuarje apo ristrukturimi të institucionit krijohet komisioni i ristrukturimit që shqyrton mundësitë e sistemimit të çdo nëpunëse/i civil në vendet e lira ekzistuese dhe propozon transferimin e nëpunëses/it në një pozitë të lirë, për të cilën i plotëson kërkesat e vendit të punës. 4. Vendimi përfundimtar i transferimit merret nga njësia përgjegjëse në bazë të propozimit të komisionit. 5. Nëpunësja/i mund të refuzojë transferimin vetëm për arsye të parashikuara në paragrafin 3. të nenit 63 të këtij ligji. Refuzimi i transferimit për arsye të tjera, përbën shkak për lirim nga shërbimi civil. 6. Komisioni i ristrukturimit, i parashikuar në paragrafin 3. të këtij neni, drejtohet nga njësia përgjegjëse dhe në të bëjnë pjesë përfaqësues të institucioneve të parashikuara në nën-paragrafët 2.1., 2.2., 2.3. apo 2.4. të këtij neni, sipas rastit ku bëhet ristrukturimi përkatës...*

Po ashtu, për trajtimin e kësaj çështje administrative Kolegji ju referuar edhe Rregullores (QRK) NR. 02/2024 për Transferimin e Nëpunësve Civilë, respektivisht nenit 12, ku përcaktohet: *“1. Nëse për shkak të shuarjes apo ristrukturimit të institucionit, pozita e mëparshme e një nëpunësi civil shuhet, ai mund të transferohet në një pozitë tjetër të shërbimit civil të së njëjtës kategori. 2. Shuarja apo ristrukturimit i institucionit përcaktohet në legjislacionin përkatës për organizimin e administratës shtetërore dhe agjencive të pavarura. 3. Transferimi sipas paragrafit 1. të këtij neni, mund të bëhet: 3.1. në të njëjtin institucion; 3.2. në institucionin që është bashkuar institucioni i shuar, në institucionin që është ndarë, apo në institucionin që ka marrë funksionet që kryente më parë nëpunësi; 3.3. në agjencinë ekzekutive të institucionit të ristrukturuar; 3.4. në një institucion tjetër të shërbimit civil. 4. Transferimi bëhet sipas radhës së përcaktuar në paragrafin 3 të këtij neni. Nëse nuk ka pozita të lira të së njëjtës kategori apo nëpunësi nuk plotëson kërkesat e pozitës së punës në të njëjtin institucion sipas nënparagrafit 3.1. të këtij neni, transferimi i tij mund të bëhet në institucionin tjetër sipas radhës së përcaktuar në paragrafin 3. 5. Nëpunësit e institucionit të ristrukturuar njoftohen individualisht nga NjMBNj për fillimin e procedurës së transferimit për shkak të shuarjes apo ristrukturimit të institucionit. Njoftimi bëhet menjëherë pas miratimit të aktit të ristrukturimit së institucionit”*.

Kështu që Kolegji i Këshillit bazuar në mandatin kushtetues dhe ligjore lidhur me mbikëqyrje të zbatimit të legjislacionit të shërbimit civil, ka analizuar aktin e kundërshtuar më ankesë në ndërlidhje me provat materiale të kësaj çështje dhe si rrjedhojë ka konstatuar se sipas Rregullores (QRK) Nr. 20/2014 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Agjencinë Kadastrale të Kosovës respektivisht me nenin 5 paragrafi 2 është paraparë Drejtorati për Gjeoinformacion ndërsa tek nën paragrafi 2.1 është paraparë Sektori për Infrastrukturën Kombëtare të Informacioneve Hapësinore (në tekstin e mëtejme IKIH), ku mbi bazë të kësaj rregulloreje ishte nxjerr Vendimi i datës 27.02.2015 i Kryeshefit Ekzekutiv të Agjencisë Kadastrale për emërimin e ankuesit në pozitën Udhëheqës i Sektorit për Infrastrukturë Kombëtare të Informacioneve Hapësinore, pozitë të cilën ankuesi pretendon se nuk e ka ushtruar, ndërsa, sipas Rregullores (QRK)-Nr. 05/2017 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (sipas nenit 85 është shfuqizuar Rregullorja (QRK) Nr. 20/2014), gjegjësisht sipas nenit 76 të kësaj rregullore, është paraparë Drejtorati për Gjeoinformacion dhe në strukturën e tij janë përcaktuar: Sektori për IKIH; Sektori i Regjistrimit të Adresave; Sektori për KOPOS; dhe Sektori për Hartografi.

Lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit, se faktikisht nuk e ka ushtruar pozitën Udhëheqës i Sektorit për Infrastrukturë Kombëtare të Informacioneve Hapësinore, Kolegji i Këshillit, ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës, dhe ka konstatuar se ankuesi më datë 02.02.2023, përmes kërkesës për sqarim me numër protokolli 02/170/23 i është drejtuar Menaxheres së Personelit të Agjencisë Kadastrale të Kosovës, përmes të cilës ka kërkuar sqarime lidhur me funksionalizimin e Agjencisë Kadastrale të Kosovës sipas Rregullores (QRK) Nr. 20/2014 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Agjencinë Kadastrale të Kosovës dhe Rregullores (QRK)-Nr. 05/2017 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, duke shtuar tutje se në kuadër të Drejtoratit të Gjeoinformacionit janë krijuar sektori për KOPOS dhe IKIH mirëpo nuk janë funksionalizuar, ndërsa, Menaxherja e Personelit e Agjencisë Kadastrale të Kosovës, më datë 02.03.2023 i është përgjigjur ankuesit në kërkesën e tij, se ende pa filluar se zbatuari Rregullorja (QRK) Nr. 20/2014 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Agjencinë Kadastrale të Kosovës, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor ka filluar hartimin e rregullores së re për organizimin e brendshëm në këtë ministri duke e përfshirë në këtë rregullore edhe organizimin e brendshëm të Agjencisë Kadastrale të Kosovës, dhe për këtë rregullore Agjencia Kadastrale e Kosovës ka shprehur pakënaqësitë e saj, dhe po ashtu agjencia ka kërkuar pezullimin e kësaj rregulloreje dhe si pasojë AKK nuk ka mundur të bëjë organizimin dhe sistematizimin e vendeve të punës sipas Rregullores Nr.20/2014.. Kurse, në përgjigjen

në ankesë të datës 15.04.2025, njësia e personelit ka deklaruar se: *...se Zyrtari F.K deri më tani ka ushtruar detyrën e Udhëheqësit të Sektorit për Infrastrukturë Kombëtare të Informacioneve Hapësinore deh se transferimi i ankuesit është bërë në kategori të njëjtë....*

Po ashtu duke u bazuar në shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, Kolegji ka gjetur një kundërthënia në mes të provave ashtu që sipas Formularëve të vlerësimit nga viti 2015 e tutje del së ankuesi është vlerësuar si Shef i Sektorit në Drejtorinë e Pronave të Paluajtshme, dhe si Udhëheqës në Drejtorinë e Gjeoinformacionit, kurse nëse i referohemi përshkrimit objektivave të punës rrjedh se kemi të bëjmë me objektiva të njëjta po që është e pamundura identifikimi i titullit të vendit të punës së ankuesit. Po ashtu sipas vet shkresave të lëndës të lëshuar nga ankuesi shihet se ai ka deklaruar pozitën e tij si Shef i Divizionit të IKIH-së.

Mbi bazën e rrethanave si më lartë, rrjedhimisht duke qenë së në procedurë ankimore nuk mund të vërtetohet saktë pozita e fundit që ka ushtruar ankuesi, përkundër faktit së ankuesi ka në fuqi Vendimin për transferimin në pozitën e Udhëheqësit të i Sektorit për Infrastrukturë Kombëtare të Informacioneve Hapësinor, për rrjedhojë Kolegji i Këshillit vlerëson së Komisioni i Ristrukturimit në rivlerësim të procesit të sistemimit të ankuesit të vërtetoj drejtë gjendjen faktike në atë mënyrë që të konstatohet se ankuesi cilin pozitë e ka ushtruar para ristrukturimit si dhe të ndërmerr të gjitha veprimet për trajtimin e rasti të ankuesit në pajtim me legjislacionin përkatës në fuqi i referohet sistemit dhe transferimit të zyrtarëve publike si rezultat i riorganizimit.

Andaj, bazuar si më sipër, Kolegji i Këshilli duke u bazuar nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi, gjegjësisht, anuloi Vendimin Nr.R.AKK 665/2025, të datës 25.03.2025, të Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik/MPB si dhe piken II me numër rendor 3 e Raportit Përfundimtar të datës 21.03.2025, të Komisionit të Ristrukturimit të Agjencisë Kadastrale të Kosovës, duke kthyer çështjen e transferimit të ankuesit pranë Komisionit të Ristrukturimit.

Këshillë juridike: *Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.602/2025

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- *Përfaqësuesit të ankuesit, Avokat Labinot Murati;*
- *Agjencisë Kadastrale të Kosovës: Komisionit të Ristrukturimit dhe Udhëheqësit të Personelit*
- *Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik në MPB, dhe*
- *Arkivit të KPMSHCK-së.*